

Fjalim i deputetit Gazment Bardhi

03.07.2023

Faleminderit, zonja Kryetare!

Të dashur qytetarë,

Qysh nga momenti kur, pas përfundimit të çdo raportimi nga krerët e institucioneve të reja të drejtësisë, nga kjo anë e sallës vijmë duartrokitje entuziaste, e kuptoni sesi është rezultati i deritanishëm i reformës në drejtësi. Sa kohë këta janë të lumtur dhe duartrokasin për punën e pabërë, në përfundim të raportimit të secilit prej krerëve të institucioneve, e kuptoni që janë në harmoni të plotë.

“Drejtësia e re e të paprekshmëve të vjetër nuk rregullohet as me rezoluta, as me rekomandime dhe as me këshilla në këtë sallë”. Kështu e kam mbyllur fjalën time ekzaktesisht një vit më parë, kur njësoj si sot miratim rezolutat për institucionet e reja të drejtësisë. Ka kaluar një vit dhe, për fat të keq, asgjë nuk ka ndryshuar. Ne vazhdojmë të bëjmë sikur rekomandojmë, ndërkohë institucionet e drejtësisë vazhdojnë të bëjnë sikur punojnë.

Kjo është tashmë një histori e njohur prej 32 vjetësh, ashtu siç është i njohur edhe fakti që në Shqipëri ka një kategori individësh që, për shkak të statusit, pozicionit apo pasurisë, kanë statusin “të paprekshëm”.

Ishte kjo drejtësia që ne donim të shembnim kur miratuam reformën në drejtësi me 140 vota në vitin 2016. Kërkuam të shembnim drejtësinë e mikut dhe shokut, drejtësinë e ndërhyrjeve politike, drejtësinë që ulte kokën përpara “të paprekshmëve”. Sot pas 7 vjetësh, me keqardhje të thellë, mund të themi se ende nuk ia kemi dalë.

Ne vazhdojmë të kemi drejtësinë e mikut dhe të shokut, vazhdojmë të kemi drejtësinë që pranon ndërhyrjet politike, vazhdojmë të kemi drejtësinë që ende nuk ka gjetur kurajën të ngrejë kokën përpara cilitdo. Për fat të keq, ne vazhdojmë të kemi drejtësinë që, për të mbuluar lirimin e paligjshëm të Saimir Tahirit, shpall në medie, pa ndodhur ende, arrestimin e Vangjush Dakos.

Për fat të keq, ne vazhdojmë të kemi drejtësinë që, për të hetuar Arben Ahmetajn, pret sinjale publike nëpër studio televizive nga Kryeministri Edi Rama. Nëse ai jep sinjale se e ka lëshuar, prokurorët marrin kurajën jo vetëm ta hetojnë, por mundësisht edhe ta denigrojnë.

Për fat të keq, ne vazhdojmë të kemi drejtësinë që, për të hetuar dhe për të arrestuar një politikan të lartë, me pasuri e para të gjetura tashmë prej kohësh jashtë vendit, po pret sinjale se kur arrestimi i tij do t'i shërbejë Kryeministrit për të mbuluar skandalin e radhës qeveritar.

Ne vazhdojmë, për fat të keq, të kemi një drejtësi ku Këshilli i Lartë i Prokurorisë i lejon vetes të shndërrojë në familje një prokurori të tërë dhe brenda një viti të emërojë aty jo dy, por plot katër persona brenda së njëjtës familje. Nuk ka asnjë reagim apo sqarim publik për këtë, i vetmi shqetësim i KLP-së gjatë këtyre ditëve është pse drejtuesi i saj do t'i nënshtrohet procesit të vetingut.

Ne vazhdojmë, për fat të keq, të kemi një drejtësi ku Këshilli i Lartë i Prokurorisë, nën këmbët e Kryeministrit, pret t'i shkojë në sallë ambasadorja amerikane që të mos emërojë drejtues të SPAK-ut një të preferuar të Edi Ramës, por dikë tjetër, që, në fakt, ishte i vetmi që nuk pranoi t'i shkonte si vartës Kryeministrit në zyrë, kur ky i fundit tentoi të hapte konkursin kryeministror për ta përzgjedhur vetë ai drejtuesin e SPAK-ut.

Kreu i Këshillit të Lartë të Prokurorisë foli këtu dhe na sqaroi pse nuk ishte impresionuar nga prezenca e ambasadores amerikane atë ditë në sallë. Në fakt, ai e di pse ambasadorja amerikane ishte atë ditë në sallë, sikundër di që ai bashkë me kolegët e tij ishin thirrur në rresht nga Kryeministri për të deklaruar mënyrën sesi do të votonim në atë mbledhje dhe se kë duhet të zgjidhnin si drejtues të SPAK-ut. Pasi kishin kaluar në pyetje dy kandidatët e tjerë në zyrën e Kryeministrit, i vetmi që nuk u paraqit atje si vartës, në fakt, ishte ai që u zgjodh, ndërsa dy të tjerët kishin raportuar sesi do ta drejtonin Prokurorinë e Posaçme para procesit të votimit të Kryeministrit, si dhe gishtin se kë duhej të votonte ky zotëria që raportoi këtu dhe kë duhej të votonin 3 të tjerët, të cilët i keni zgjedhur në mënyrë të njëanshme si anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Ne vazhdojmë, për fat të keq, të kemi një drejtësi ku Prokurori i Përgjithshëm, i cili qenka larguar, merr bekimin e mazhorancës në këtë sallë, vetëm pasi provon se është besnik i familjes kryeministore dhe hedh në erë një dosje të tërë, duke veçuar procedimin me nr. 335/1 (ai e di për çfarë bëhet fjalë) dhe duke shpallur të pidentifikuar atë që e identifikon lehtësisht çdo qytetar në rrugë, por që për Prokurorin e Përgjithshëm, asokohe prokuror i çështjes, mbetet edhe sot e kësaj dite si personi i moshës 45 vjeç me flokë të shkurtër apo përdorues i automjetit me targa AA653DM.

Ne vazhdojmë, për të fat të keq, të kemi një drejtësi ku Gjykata Kushtetuese, pasi merr në punë në të njëjtin pozicion drejtoreshën e kabinetit të ministres Spiropali, ka një standard për bordin e ushqimeve dhe një standard tjetër për bordin e karburanteve, edhe pse janë identike, me dallimin e vetëm që për të dytin Kryeministri ka interes të drejtpërdrejtë.

Prandaj, të nderuar kolegë, për sa kohë ju në këtë sallë i mbushët institucionet e reja të drejtësisë me miqtë dhe shokë tuaj, të cilët vazhdojnë edhe në detyrë të sillen si miqtë e shokët tuaj, qytetarët do të presin më kot drejtësi. Ajo do të jetë drejtësia juaj, por jo drejtësia që prisnin qytetarët. Ajo

do të jetë drejtësia e Kryeministrit, por jo drejtësia e qytetarit të zakonshëm. Ne do të vazhdojmë të bëjmë sikur lëshojmë rekomandime, ndërkohë që institucionet e drejtësisë do të vazhdojnë me qoka e ndere, duke i çuar familjarët tuaj sa prokurorë në një prokurori dhe sa drejtues në një prokurori tjetër.

Është e vërtetë që gjatë këtyre ditëve ne jemi duke punuar për disa ndryshime në ligjet e reformës në drejtësi. Opozita është përfshirë në atë proces që në fillim me bindjen e plotë se reforma në drejtësi duhet të ecë përpara, duke u përpjekur të shpëtohet, aq sa mund të shpëtohet. Edhe në atë proces unë dhe kolegët e mi jemi dëshmitarë se si institucionet e reja të drejtësisë më shumë kishin merakun si të rrisnin kompetencat dhe privilegjet e tyre, jo si t'u shërbenin më mirë qytetarëve.

Dua të jem fare i qartë: opozita mbështet dhe do të mbështesë çdo ndryshim që rrit eficiencën dhe efikasitetin e sistemit të drejtësisë, por ne nuk do të mbështesim asnjë rol të shtuar të Prokurorit të Përgjithshëm, të procedimit nr. 335/1; asnjë lehtësim të rregullave të hyrjes në sistemin e drejtësisë; asnjë favorizim apo lehtësim për anëtarët familjarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë apo Këshillit të Lartë Gjyqësor, që kërkojnë privilegje të shtuara për veten e tyre.

Reforma në drejtësi ishte dhe mbetet kërkesë e shumicës dërrmuese të qytetarëve shqiptarë, që mendonin e besonin se kjo reformë do t'i jepte fund pandëshkueshmërisë, do të siguronte barazinë para ligjit dhe do t'u hiqte përfundimisht statusin “të paprekshëm” një grushti njerëzish që kontrollojnë qeverisjen dhe ekonominë e vendit. Pra, për të arritur këtë qëllim, vota jonë do të jetë gjithmonë pro, por vetëm për këtë.

Qytetarët duhet të fillojnë ta marrin mbrapsht besimin që investuan te reforma në drejtësi; duhet të shikojnë që ata, që deri dje gëzonin statusin “të paprekshëm”, të ndiejnë frikën e asaj që ne e quajmë drejtësia e re.

Të nderuar kolegë, koha është tani, ju siguroj se nesër do të jetë shumë vonë.

Faleminderit!